

Fatmira MUSAJ

HYRË EMINI - NJË JETË NË SHËRBIM TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

Kosova, në vitet e '80-ta dhe veçanërisht në vitet e '90-ta të shekullit të kaluar, ndodhej në një gjendje të rëndë, për shkak të dhunës sistematike, të ushtruar nga autoritetet pushtuese serbe, si në jetën politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të vendit. Për të nxjerrë vendin nga kjo situatë e vështirë, forcat legale dhe ilegale në Kosovë, braktisën rrugën paqësore të rezistencës dhe vendosën të kalonin në fazën më të lartë të saj, në atë të luftës së armatosur, për liri dhe pavarësinë e Kosovës. Për realizimin e kësaj detyre të shenjtë, u formua Ushtria Çlirimtarë e Kosovës (UÇK), në radhët e së cilës milituan bijat e bijtë më të mirë të Kosovës e trevave të tjera shqiptare dhe të mërgatës. Midis tyre ishte edhe intelektualja, atdhetarja, vajza trimëreshë nga Ferizaj, Hyrë Qazim Emini (emri i saj i luftës ishte "Mira").

Hyra u lind më 21 korrik të viti 1973 në Ferizaj. Në formimin e karakterit e të personalitetit të saj, me virtytet më të larta njerëzore e patriotike, ndikuan ambienti familjar si dhe zhvillimet e vrullshme politiko-shoqërore që ndodhën në Kosovë e me gjerë, në këtë periudhë. Prindërit e Hyrës nuk u pajtuan asnjëherë me regjimin serbo-jugosllav dhe politikat e tyre antishqiptare. Pikërisht për këtë, familja u vu nën presionin e dhunën rankoviçiane dhe në vitin 1958 u

detyrua të shpërngulej nga fshati Maçitevë i Suharekës, drejt Turqisë.¹ Në pamundësi për të vazhduar udhëtimin, familja vendoset në Maqedoni deri në rënien e Rankoviqit. Pas kësaj, rikthehet në Kosovë në fshatin Neredime të Ferizajt e më vonë familja vendoset me banim në këtë qytet.² Veç qëndresës së prindërve, frymëzim për Hyrën dhe vëllezërit e saj, ishte daja i tyre Shaban Biba-Jezerci. Ai bashkë me luftëtarë të tjerë të krahinës së Jezercit, kishin kundërshtuar me armë, ripushtimin e Kosovës nga Jugosllavia, pas Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1947 ai ishte detyruar të dorëzohej dhe u dënua me 14 vjet burg.³ Shabani, në vizitat e shpeshta që i bënte familjes së motrës, në prani të nipërve dhe mbesave, rrëfente për qëndresën e tij kundërjugosllave, se si sigurimi i shtetit, i kishte marrë peng familjen për ta detyruar që të dorëzohej. Gjithashtu, u tregonte për vuajtjet dhe torturat që autoritetet e burgjeve kishin ushtruar mbi të për vite me radhë, për të mposhtur shpirtin e tij liridashës. Në këtë mënyrë ndikoi tek ata, në rritjen e urrejtjes kundër pushtuesve dhe dëshirës për të qenë të lirë e të pavarur. “Hyra, - theksonte nëna Nazlime, - ishte vetëm gjashtë vjeç, i dëgjonte në qetësi rrëfimet e dajës së saj dhe në shenjë dhembshurie i shtrëngonte duart”.⁴ Ajo çka e lëndoi shumë Hyrën, ishte arrestimi nga UDB-ja i vëllait të madh Ramadanit, në vitin 1985. Ai u dënua me 5 vjet burg, për veprimtari ilegale kundër regjimit jugosllav.⁵ Kjo shtoi te Hyra urrejtjen ndaj regjimit.

Ajo tashmë 12 vjeç, së bashku me nënë Nazlimen e vizitonte vëllain në burgjet e Prizrenit, Gurrakocit e Prishtinës dhe i përjetoi me dhimbje vuajtjet e vëllait deri në lirinë e tij, në vitin 1990. Aktiviteti i tij atdhetar dhe i pjesëtarëve të tjerë të familjes, që përcillej në biseda familjare dhe më gjerë, ndiqej me interes nga Hyra e do të rrënjosin në mendjen dhe shpirtin e saj, tiparet dalluese të kësaj familjeje, si atdhedashurinë, papërkulshmërinë ndaj regjimit dhe dëshirën për liri. Këto tipare u zhvilluan dhe u forcuan bashkë me rritjen e saj. Këtë e

¹“Feniksët e Lirisë”. (Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), libri i tretë, SHVLUK, Prishtinë, 2003. Hyrë Qazim Emini, 133; Radio “Kosova e Lirë”, emision kushtuar dëshmores së lirisë Hyrë Qazim Emini.

² Marrë nga arkivi i familjes.

³ Po aty.

⁴ Intervistë e nënës Nazlime, dhënë në: “UÇK, dokumentari i Tetes dhe Mirës” pjesa 1.

⁵ Ramadanit ishte pjesë e organizatës ilegale “Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës” (OMLK). Informacion i marrë nga arkivi i familjes Emini.

vërente nga afër nëna Nazlime, e cila, në një nga dokumentarët kushtuar të bijës, theksonte: “se kjo, (*d.m.th ideali për liri, F.M*) shkojka për gjak”.⁶ Veç vuajtjeve që regjimi kishte shkaktuar në familjen e saj, Hyra tashmë në moshën e adoleshencës dhe të pjekurisë do të përjetonte ngjarje të rëndësishme në historinë e re të Kosovës. Demonstratat e fuqishme studentore të vitit 1981, me kërkesa politike, ekonomike e shoqërore, u mbështetën edhe nga vëllezërit e saj.⁷ Masat represive disavjeçare që ndërmori Beogradi në Kosovë, prekën ashtu si shumë familje atdhetarësh, edhe familjen e Hyrës.

Procesi i shpërbërjes së Federatës Jugosllave, suprimimi i autonomisë së Kosovës në mars 1989, që i hapi udhën Serbisë ta aneksonte atë në korrik 1990, likuidoi autonominë e Kosovës dhe vendosi regjimin policor e ushtarak. E gjithë atmosfera e rëndë politike, ekonomike, shoqërore, institucionale, që u krijua në Kosovë, ndikuan drejtpërsëdrejti në pjekurinë politike të Hyrës, rreshtimit të saj në anën e duhur për t’i kontribuar çështjes kombëtare, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Kështu Hyra gjatë viteve në gjimnazin “Faik Konica”, veç etjes për dije gjatë procesit mësimor, ajo siç theksonte vëllai i saj Ramadani, e dashuronte fort librin⁸. Nëpërmjet literaturës artistike, historiko-politike, zgjeronte njohuritë e saj në këto fusha. Veçanërisht atë e tërhiqte historia e shqiptareve dhe ajo e luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare e popullit shqiptar, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shembulli i heronjve të kësaj lufte si Qemal Stafa etj. dhe e udhëheqësit e komandantit të saj Enver Hoxha portretet e të cilëve, si dhe të shumë heronjve të heshtur të Lëvizjes Ilegale në Kosovë, ajo i ruante e frymëzohej nga trimëria dhe guximi i treguar prej tyre në luftë për çlirim kombëtar. Madje, edhe emrat e luftës, “Mira” (Hyra) dhe “Jeta” (Hyrije Velu) sipas kujtimeve të kësaj të fundit, ishin marrë nga filmi shqiptar “Vajzat me kordele të kuqe”, në të cilin pasqyrohej pjesëmarrja e grave dhe vajzave shqiptare në luftën antifashiste.⁹ Nën ndikimin edhe të vëllezërve e aktivistëve të Lëvizjes Ilegale në Ferizaj, brenda mundësive që ia lejonte moshën, filloi

⁶ Intervistë e nënës Nazlime dhënë në: “UÇK, dokumentar i Tetes e Mirës”, pjesa 1.

⁷ Marrë nga arkivi i familjes.

⁸ Intervistë e vëllait të Hyrë Eminit, Ramadan Eminit për: “UÇK, dokumentar i Tetes e Mirës”, pjesa 1.

⁹ Kujtime të Hyrije Velut për Hyrë Eminin.

veprimtarinë në shërbim të çështjes kombëtare. Mori pjesë në të gjitha aktivitetet kulturore e artistikë brenda dhe jashtë shkollës, duke kontribuar në mbajtjen lart të frymës atdhetare në mjedisin e nxënësve të shkollës dhe më gjerë.¹⁰ Si aktiviste e shquar, ajo ishte ndër të parët persona, që Bajrush Xhemajli¹¹ do t'i propozonte, për të qenë anëtare e Degës së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut për Ferizajn, që u themelua në prill 1991.¹² Ajo e pranoi pa mëdyshje propozimin.

Si anëtare në një organizatë të pavarur legale, do të mbronte të drejtat dhe liritë e bashkëqytetarëve të saj, e të demaskonte hapur politikën antishqiptarë të Beogradit ndaj popullit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Hyra megjithëse ishte më e reja në Këshill, kjo nuk e pengoi aspak për të marrë pjesë në diskutime e debate për çështje të ndryshme që shtroheshin aty, në mënyrë që detyrat të kryheshin sa më shpejt dhe më mirë. “Ajo, - theksonte kryetari i Këshillit, -Bajrush Xhemajli, në diskutime e debate ndihej e barabartë midis të barabartëve. Inferioriteti për të ishte i huaj”.¹³ Bajrush Xhemajli e disa anëtarë të Këshillit, si: Sevdije Bajraliu, Rexhep Bislimi, Sejdi Sejdiu, të cilët ishin edhe anëtarë të organizatës ilegale LBK¹⁴, arritën të vendosin një bashkëpunim të ngushtë midis Lëvizjes Ilegale dhe asaj legale, ku edhe Hyra dha ndihmesën e saj.¹⁵ Hyra pas përfundimit të gjimnazit në vitin 1993, filloi studimet e larta në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filologjikë, në Degën Gjuhë dhe Letërsi. Krahës procesit mësimor, Hyra mendoi të shrinte veprimtarinë patriotike të nisur në qytetin e lindjes edhe në mesin e studentëve. Ajo u njoh me studentë dhe studente të të njëjtit ideal, si me Hyrije Velin, Nait Hasanin etj., që më vonë shumë syresh, iu bashkuan UÇK-së. Në mjedisin e tyre diskutohej për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej

¹⁰ Marrë nga arkivi i familjes Emini. Hyra për rezultate të larta dhe si aktiviste e shquar, u shpall nxënësja më e dalluar e gjimnazit “Faik Konica” në Ferizaj.

¹¹ Bajrush Xhemajli, ishte nismëtar i themelimit të Degës së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut në Ferizaj. Pas themelimit u zgjodh kryetar i Këshillit.

¹² Intervistë e Bajrush Xhemajlit, për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 1.

¹³ Po aty.

¹⁴ LBK, ishte organizata marksiste-leniniste e Kosovës, dega Ferizaj.

¹⁵ Nga intervista e Sami Hajrullahut, për “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 1.

Kosova. “Hyrën, - theksonte shoqja e saj Hyrije Velu, - e karakterizonte pjekuria e mendimeve. Ajo ishte e bindur se për shpëtimin e Kosovës, nuk kishte rrugë tjetër veç luftës së armatosur çlirimtare. Këtë ajo e shihte si mjetin përfundimtar e të pashmangshëm për çlirimin e Kosovës”.¹⁶

Por për të arritur deri këtu, duhej punuar fort për të mbajtur lart frymën atdhetare te studentët. Në kushtet eurvejimit të sigurimit serb, shfrytëzuan klubin studentor, ku organizuan dhe zhvilluan një sërë veprimtarish kulturore me tematikë patriotike, duke tërhequr pas vetes qindra studentë.¹⁷ Në të njëjtën kohë ajo nuk i shkëputi lidhjet me aktivistët në Ferizaj. Më iniciativën e saj dhe me mbështetjen e tyre, në këtë qytet, në janar të 1993, u organizua manifestimi “Flaka e Janarit”, me rastin e 12-vjetorit të vrasjes nga UDB-ja të vëllezërve Gërvalla e të Kadri Zekës dhe 10-vjetorit të vrasjes së Rexhep Malës e Nuhi Berishës.¹⁸

Në përkujtim të veprës së tyre atdhetare, Hyra shquhet si organizatore në përgatitjen e programit dhe të grupit të recituesve të ngritur prej saj. Manifestimi përcolli te rinia dhe qytetarët e Ferizajt, përpjekjet e heronjve të heshtur të Lëvizjes Ilegale për liri, pavarësi e bashkim kombëtar duke ndikuar tek ata, në rritjen e urrejtjes kundër pushtuesve vrashtarë serbë. Shfaqja u mirëprit nga publiku. Por, kjo krijoi shqetësim te autoritetet serbe dhe u konsiderua prej tyre si veprimtari armiqësore. Hyra si organizatore kryesore u arrestua dhe u dënua më dy muaj burg. Ajo dhe aktivistë të tjerë të organizimit të këtij manifestimi, u konsideruan të rrezikshëm për regjimin dhe u arrestuan. Pas pak ditësh Hyrës, sigurimi serb ia ktheu pasaportën, me kusht që të largohej nga Kosova.¹⁹ Këtë politikë, serbët e kishin ndjekur edhe te shumë shqiptarë të Kosovës, kundërshtarë të regjimit. Më largimin e tyre nga Kosova, ata synonin të minimizonin kontingjentin e shqiptarëve që po përgatiteshin për kryengritje në konfliktin e afërt me ta.²⁰ Ajo e hodhi poshtë propozimin e tyre dhe

¹⁶ Intervistë e Hyrije Velut, në: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Hyrës”, pjesa 1.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ “Feniksët e Lirisë”, 134.

¹⁹ Marrë nga arkivi i familjes. Serbët me politikën e ndjekur ndaj shqiptarëve të Kosovës, o burg, o largohu nga Kosova, në vitet 1992-1994, kishin arritur të largonin 400 shqiptarë midis të cilëve edhe aktivistë të Lëvizjes Ilegale.

²⁰ Po aty.

pranoi vuajtjen e dënimit me burg në Lipjan dhe Pozharec të Serbisë.²¹ Qëndrimi në burg, e bëri Hyrën edhe më të fortë dhe më të vendosur për t'i shkuar deri në fund realizimit të qëllimit dhe idealit të saj. Pas daljes nga burgu, ajo u konsiderua element i rrezikshëm për regjimin dhe ndiqej hap pas hapi. *“Hyra, - theksonte vëllai i saj, Ramadan, - rrezikohej me një burgosje të dytë edhe për veprimtari të tjera, andaj e pamë të udhës largimin e saj nga Kosova drejt Shqipërisë, ku u vendos në Tiranë bashkë me familjen”*.²² Ajo e përjetoi keq ndarjen nga shokët e miqtë e idealit dhe detyra që i kishte vënë vetes për të luftuar me të gjitha mjetet për çlirimin e Kosovës. *“Hyra, - theksonte shoqja e saj, H. Veliu, - asnjëherë nuk lejoi që dëshpërimi ta gjunjëzonte dhe fati t'i diktonte drejtimin e jetës në të ardhmen”*.²³

Çështja e Kosovës ishte për të gjithë dhe asgjë nuk mund ta ndante. Kështu vazhdoi lidhjet me aktivistët e lëvizjes në Ferizaj dhe shokët e shoqet studentë në Prishtinë ku informohej për gjendjen në Kosovë. Babë Qazimi, ishte mbështetës i flaktë i rezistencës së bijve të tij. Ai u bë postieri më besnik i saj, duke i siguruar letërkëmbimin me shoqet e shokët si në Ferizaj ashtu edhe në Prishtinë.²⁴ Hyra informohej për situatën gjithnjë e më të rëndë që po kalonte Kosova si dhe për rritjen e organizimit të rezistencës shqiptare.

Në vitin 1994 nisi studimet e larta në Tiranë në Fakultetin Histori-Filologji, Dega: Gjuhë dhe Letërsi. Pikërisht në këtë kohë e njoha Hyrën. Ajo, bashkë me shoqet e saj nga Kosova, Sevdije Bajraliun dhe Fikrije Berishën (të përndjekura nga regjimi serb), për të rritur e zgjeruar njohuritë e marra në leksione, frekuentonin shpesh sallën shkencore në Bibliotekën Kombëtare. Hyra ishte e qetë, tip inteligjent, serioze dhe e komunikueshme. Atë e shqetësonte gjendja e rëndë që kaloi Shqipëria në vitin 1996-1997, e cila nuk ishte aspak ndihmuese për Kosovën. Prezantimi i UÇK-së më 28 nëntor 1997, u mirëprit prej saj. Për të, përfshirja në radhët e Ushtrisë Çlirimtare ishte detyrë mbi detyrat. Kështu ndërpreu studimet në vitin e fundit dhe hyri në lidhje me luftëtarë të UÇK-së ndër ta edhe Adrian Krasniqi

²¹ Marrë nga arkivi i familjes.

²² Intervistë e vëllait të Hyrës Ramadan Emini, për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 1.

²³ Lëvizja Vetëvendosje, aktivitete kushtuar ditës së Pavarësisë. Tribune kushtuar Kontributit të grave në luftën çlirimtare 1997-1999. Kumtese e mbajtur nga Hyrije Veliu me titull “Kujtime nga Lufta”. Më 28 nëntor 2011.

²⁴ Kujtime të Hyrije Velikut.

(dëshmor i atdheut), për të gjetur mundësinë e kthimit në Kosovë.²⁵ Në fund të muajit maj 1998, Hyra mbërriti në Ferizaj. Shfrytëzoi të gjitha lidhjet me aktivistët e lëvizjes në Ferizaj për t'iu bashkangjitur sa më parë radhëve të UÇK-së. Isak Biba, i cili do ta shoqëronte Hyrën për në front, vërente tek ajo padurimin, për t'u bërë pjesë sa më parë e ushtrisë çlirimtare. “Nuk e di a do të mundem t’ia arrij kësaj, - i ishte shprehur Hyra, - por vetëm sa të marr automatikun në dorë, pastaj dhe në vdeksha nuk kam gajle”.²⁶

Duke parë vendosmërinë e saj, Isak Biba theksonte se: “Nuk di së çfarë guximi dhe vullneti ka pas ajo çikë”.²⁷ Në fundin e qershorit e shoqëruar prej tij, arriti t’i bashkohej radhëve të para të UÇK-së në Papaz të Suharekës.²⁸ Kështu Hyra, ishte ndër të parat vajza që u inkuadrua në radhët e para të UÇK-së, në pikën ushtarake në Jezerc, e cila sapo ishte formuar dhe komandohej nga Imri Iljazi ose komandant “Ferri”.²⁹ Kësaj njësie luftarake i caktua detyra për të hyrë në fshatin Jezerc.³⁰ Për këtë Hyra veshi rrobat ushtarake, u pajis me armatim dhe nisi menjëherë përgatitjet krah bashkëluftëtarëve, për të shkuar në front. Nga data 16 deri më 18 korrik 1998 ajo mori pjesë në luftimet kundër forcave serbe deri në shpalljen e Jezercit territor i lirë.³¹

Që nga ky moment, Hyra iu përkushtua tërësisht luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar. Në gjithë materialin e shkruar dhe audiovizivë, materiale të familjes së Hyrës si dhe nga kujtimet e bashkëluftëtarëve më të ngushta të saj si, Vjollca Neziri, Hyrije Velu, ushtarakë komandues etj., evidentohen tiparet dhe karakteristikat e veçanta që ajo shpalosi gjatë gjithë veprimtarisë në luftën për çlirimin e Kosovës e trevave të tjera shqiptare. Në ofensivën e vjeshtës së vitit 1998, ajo u shqua jo vetëm si luftëtare por edhe për ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në kryerjen e detyrave luftarake. Para çdo beteje, ajo i kushtonte rëndësi njohjes së mirë të terrenit e të situatës ku do të

²⁵ Intervistë e vëllait të Hyrës, Ramadan Emini për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 1.

²⁶ Intervistë e Isak Bibës për: “UÇK, dokumentar i Tetës dhe Mirës”, pjesa 2.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

²⁹ Intervistë e Imri Iljazit, komandant “Ferri”, për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 2. Marrë nga kujtimet e bashkëluftëtarës së Hyrës, Vjollca Neziri.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty. Pas shpalljes së Jezercit territor i lirë, u zyrtarizua Nënzona e Parë Operative e Neredimes me rrethinë.

zhvilloheshin luftimet.

Me vetiniciativë bënte vëzhgimin e pikave të mundshme për sulmin kundër forcave serbe.³² Veçanërisht trimëria, guximi dhe heroizmi i saj, spikasnin në çdo veprim luftarak për çlirimin e territoreve të nënzonës së parë operative të Neredimes. Në sulmin kundër forcave armike, shprehet V. Neziri në kujtimet e saj, Hyra zgjodhi të luftonte në pozicionet e pikës së parë që ishin më të afërta më pozicionet e forcave serbe.³³ Pas luftimeve të ashpra humbën jetën nëntë luftëtarë të UÇK-së.³⁴ Në këtë situatë komanda urdhëroi ndarjen e forcave në grupe më të vogla, për të vepruar më lehtë.³⁵ Hyra zgjodhi vullnetarisht të qëndronte në grupin e luftëtarëve në Jezerc. Të pozicionuar në pikën e parë afër xhamisë dhe në pikën e dytë në Prerok, Hyra me grupin e luftëtarëve, luftuan dy ditë e dy net kundër forcave të shumta serbe. Gjatë luftimeve ajo, - shprehet bashkëluftëtari i saj, Gëzim Baliu, - gjendej aty ku rreziku ishte më i madh. Guximi, vigjilenca dhe gatishmëria e saj për vetëflijim, ne ushtarëve të papërvojë na befasonte.

Në luftimet kundër forcave të shumta serbe, ajo dhe pesë vajza të tjera, luftuan si sokolesha duke u bërë shembull frymëzimi për luftëtarët e tjerë.³⁶ Për të realizuar nevojat që dilnin në situata të ndryshme gjatë betejës dhe pas saj, Hyra vepronte me iniciativë dhe vullnetarisht. Kështu gjatë luftimeve në Prerok, pa marrë parasysh rrezikun që sillte udhëtimi deri në vendndodhjen e komandës, e cila ndodhej në pikën 1, në shoqërinë e Gëzim Baliut shkuan, tërhoqën materialet e nevojshme, e u kthyen përsëri në luftime.³⁷ Për t'u ardhur në ndihmë të plagosurve, bashkë më luftëtarin e shquar Nazmie Tërshana (emri i luftës "Malsorja"), sollën mjekun kirurg nga Ferizaj në Jezercë.³⁸ Hyra gjendej gjithnjë në vijën e parë të frontit dhe zgjidhte pozicionet më të rrezikshme për jetën. Ajo nuk priste urdhra

³² Kujtime për Hyrën, të Vjollca Nezirit.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

³⁶ Emission kushtuar dëshmoresh Hyrë Qazim Emini, 21.07.1973-29.07.2001, në radio "Kosova e Lirë".

³⁷ Po aty.

³⁸ Nazmie Tërshana (emri i luftës "Malsorja"). Nazmia, ishte ndër luftëtarët e Nënzonës Operative të Neredimes që shquhej për trimëri e guxim: marrë në Kujtimet e Vjollca Nezirit për Hyre Eminin.

për situatat që krijoheshin gjatë veprimeve luftarake, vepronte me iniciativë për zgjidhjen e tyre dhe zhvendosej nga një pozicion në tjetrin duke mbështetur e inkurajuar luftëtarët e tjerë. Asaj i dhimbsej jeta e çdo luftëtarë që binte në betejë dhe betohej para tyre, “se do të merrte hak”. *“Sa e qetë ishte në natyrën e saj, - shprehet Vjollca Neziri, - aq shpërthyesë e energjike ishte në vijën e sulmit”*.³⁹ Pas largimit të forcave armike, Hyra nuk mund të linte pas shokët e rënë në atë ofensivë. Ajo rikthehej e para në pozicione dhe punonte me grupin e caktuar për gjetjen e trupave të tyre, bënte fotografimin dhe mbante shënime për secilin. Bënte incizime me kamerë kur ishte e nevojshme etj.⁴⁰ Për trimërinë dhe guximin e treguar në sulmet për çlirimin e Jezercit, Hyra dhe Ahmet Kaçiku u caktuan nga komanda dhe patën nderin, të ngrinin flamurin kombëtar në Jezercin e lirë.⁴¹

Më krijimin e Zonës Operative të Nerodimes në nëntor 1998, Hyra për aftësitë, inteligjencën e trimërinë e saj, zgjidhet në strukturat komanduese të kësaj zone. Ajo, - theksonte Shukri Buja, - ishte një nga vajzat e rralla udhëheqëse në UÇK.⁴² Me shtimin e radhëve të luftëtarëve, krijohen edhe dy brigada të tjera. Hyra ishte pjesë e Brigadës 161 me komandant Ahmet Kaçikun. Ajo ndihmoi në organizimin dhe konsolidimin e saj. Kjo brigadë u ngarkua nga komanda me detyrën, për ruajtjen e trupave të civilëve të vrarë e të masakruar më 15 janar 1999 në Reçak, ndaj orvatjes së trupave serbe për t'i zhvendosur e për të zhdukur gjurmët e krimit. Hyra e komandant Kaçiku më 16-18 janar, udhëhoqën luftimet e ashpra kundër forcave serbe ku mbetën të vrarë 10 luftëtarë midis tyre dhe komandant Kaçiku.⁴³

Lufta heroike dhe e paepur e tyre dhe e luftëtarëve të Brigadës 161 në Reçak, pati rëndësi të veçantë për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo i tregoi opinionit brenda dhe jashtë vendit, për masakrat e pashembullta që trupat serbe po kryenin mbi popullsinë e pafajshme në Kosovë. Gjithashtu fotot e të masakruarve në Reçak të bëra nga Hyra dhe reporterë të tjerë të zonës së Nerodimes, u publikuan në shumë media botërore. Kjo nxiti diplomacinë

³⁹ Vjollca Neziri, Kujtime për Hyrë Eminin.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Shukri Buja, ish-komandant i Zonës Operative të Nerodimes.

⁴³ Vjollca Neziri, Kujtime për Hyrë Eminin.

perëndimore për të ndërhyrë sa më shpejt, për të penguar përsëritjen e një Bosnjë të dytë, megjithëse në Kosovë, tashmë gjenocidi kishte ndodhur.

Në fund të janarit 1999, Hyra caktohet me detyrën e oficerës së personelit të Zonës Operative të Nerodimes. Por krahas kësaj detyre të cilën e kryente me përgjegjësi, ajo nuk iu shmang për asnjë moment luftës në front. Vullnetarisht iu bashkëngjit efektivit që mbështetën luftëtarët në vijën e parë të frontit, në Drëmjak⁴⁴ dhe mori pjesë në të gjitha veprimet luftarake gjatë ofensivës së prill-majit 1999. Për Hyrën nuk kishte pushim. “Në intervalet midis luftimeve, - kujton Vjollca Neziri, - ajo ndodhej në mesin e ushtarëve. Me oratorinë dhe me aftësinë komunikuese, mbante lart moralin e luftëtareve, rriste optimizmin dhe besimin në fitore. Recitonte dhe këndonte bashkë me ta, këngë të Ushtrisë Nacional Çlirimtare shqiptare të Luftës së Dytë Botërore, të përshtatura për UÇK-në. Hyra e vlerësonte dokumentimin e luftës. Veç armatimit ajo mbante me vete kamerën dhe aparatën fotografik. Shfrytëzonte çdo mundësi për të filmuar aksionet luftarake, fotografonte të rënë dhe i pajiste me mjete identifikimi. Mbante shënime e hartonte kronika për ngjarje të ndryshme. Me krijimin e institucioneve të informimit të UÇK-së, radio “Kosova e Lirë” dhe agjencia “Kosovapress”, ajo u bë reportere e tyre, për Zonën Operative të Nerodimes.⁴⁵ Puna e saj në këtë drejtim i kontribuoi krijimit të arkivit të UÇK-së. Lufta e UÇK-së dhe ndërhyrja ushtarake e NATO-s, e detyroi Serbinë të kapitultojë pa kushte.

Më 9 qershor 1999 u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës, ku u vendos tërheqja e trupave serbe nga Kosova dhe hyrja e trupave të NATO-s. Më 12 qershor, Komanda e Zonës Operative të Nerodimes, ngarkoi Hyrën në krye të një grupi luftëtarësh, të hynte në Ferizaj. Pas vlerësimit të situatës, më 14 qershor u përqendrua edhe pjesa tjetër e luftëtarëve. Në Ferizajn e çliruar, Hyra krahas detyrave të ngarkuara nga komanda, punoi për propagandimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe e ndjente si detyrim nderimin dhe përkujtimin e të rënëve për liri. Ajo bashkë me Brahim Ademin, Vjollca Nezirin, Nazmie Tërshanën e ish-luftëtarë të tjerë në Ferizaj, organizuan akademi dhe orë përkujtimore kushtuar dëshmorëve si dhe betejave më të rëndësishme të luftës. Përgatiti skenarin e dokumentarit kushtuar komandant

⁴⁴ Intervistë e Imi Ramushollit për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 2.

⁴⁵ Vjollca Neziri, Kujtime për Hyrë Eminin.

Ahmet Kaçikut etj., përgatiti ekspozitën me rastin e çeljes së kazermës ushtarake në Ferizaj etj.⁴⁶ Pas një pune intensive në sektorin ushtarak dhe atë politik si kryetare e PDK-së për Ferizajn, Hyra në shtator 1999, filloi punë në Akademinë Ushtarake të Trupave të Mbrojtës së Kosovës (TMK). Ajo do t'i përkushtohej me tërë seriozitetin, përgjegjësinë dhe inteligjencën që e karakterizonte, realizimit të detyrës në Akademi. “Ajo ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në komandën e Akademisë së Mbrojtjes, - theksonte Rexhep Selimi. Më punën e saj dhe të kolegëve, i dhanë shtytje të madhe zhvillimit të këtij institucioni shumë të rëndësishëm si për TMK-në dhe për të ardhmen e ushtrisë së Kosovës. Rezultatet e punës së tyre, bënë që ky institucion të jetë ndër më të zhvilluarit në TMK”.⁴⁷

Ndonëse ishte tepër e lidhur më detyrën që kishte, Hyra nuk ndihej e qetë me fillimin e luftës së shqiptarëve në Kosovën Lindore. Për të lufta ende nuk kishte përfunduar. Këtë ma pohoi në takimin që pata më atë, në shtator të vitit 2000, në TMK.⁴⁸ Këshillave të kolegëve, miqve dhe më të shtrenjtës nënës Nazlimes, se mjaft kishte luftuar dhe se duhej të shihte jetën, u ishte përgjigjur, se: “Nuk mund t’ua kthente shpinën vëllezërve që i kishin ndihmuar aq shumë luftës së Kosovës, dhe se nuk do ta lëshonte armën nga dora derisa të bashkoheshin trojet etnike”.⁴⁹ “Ajo, - thekson Hyrije Veliu, - besonte se popujt mund ta ndryshojnë vetë fatin e tyre dhe ishte e bindur se bashkimi i trojeve shqiptare në një shtet të vetëm, do të përmbushte kërkesat e natyrshme të shqiptarëve për të jetuar të bashkuar e sovran”.⁵⁰

Në shërbim të kësaj ideje do të luftonte deri në frymën e fundit, për të bërë realitet betimin e ushtarit të UÇK-së. U angazhua dhe punoi me tërë qenien e saj, për të ndryshuar pozitën e vëllezërve në trevën e Kosovës Lindore dhe të atyre në Maqedoni. “Duke njohur temperamentin e gatishmërinë e Hyrës, shprehet Vjollca Neziri, isha e bindur që ajo do të ishte pjesë e asaj lufte”.⁵¹ Për këtë, Hyra bashkë

⁴⁶ Vjollca Neziri, Kujtime për Hyrë Eminin.

⁴⁷ Intervistë e Rexhep Selimit për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 3.

⁴⁸ Fatmira Musaj, pohim i Hyrës në takimin më atë, në vitin 2000 në TMK.

⁴⁹ Intervistë e nënës Nazlimes për: “UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës”, pjesa 4.

⁵⁰ Lëvizja Vetëvendosje, aktivitete kushtuar Ditës së Pavarësisë. Tribune kushtuar kontributit të grave në luftën çlirimtare 1997-1999. Kumtesë e mbajtur nga Hyrije Veliu, “Kujtime nga lufta”, Prishtinë, 2011.

⁵¹ Vjollca Neziri, Kujtime për Hyrë Eminin.

me luftëtarin e UÇK-së Tahir Sinani (nga Tropoja, Shqipëri) vendosën lidhje me duke u bërë herë pas herë pjesë e saj. Por me fillimin e luftës në trojet shqiptare të Maqedonisë, Hyra e pranoi pa mëdyshje planin e Tahir Sinanit, i cili ishte miratuar nga Shtabi i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, për formimin e Brigadës 116 e cila do të përqendrohej rrëzë malit të Korabit e më pas do të depërtonte deri në pjesën qendrore të Maqedonisë.⁵² Në prill 2001, komandant Tahir Sinani dhe Hyra, nisën punën për afrimin e ish-bashkëluftëtarëve të UÇK-së në radhët e njësitit, si: Brahim Ademi, Vjollca Neziri, Naser Ademi etj.

Në fund të prillit e në maj, Tahir Sinani e Hyra, shkojnë në Dibër për të bërë rikonicionin e terrenit, ku do të shtrihej brigada. Në maj 2001, Hyra jep dorëheqjen nga detyra në TMK në Prishtinë dhe i përkushtohet totalisht organizimit të kësaj force ushtarake. Më 16 qershor, bashkë me komandant Tahir Sinanin dhe anëtarët e njësitit, Brahim Ademi, Vjollca Neziri, Naser Ademi, Isa Fazliu etj., kalojnë nga Kukësi në Radomirë për të vazhduar më tutje.⁵³ Veç strukturimit të brigadës, Hyra kontribuonte në përgatitjen psikofizike të luftëtarëve dhe mbajtjen lart të moralit të tyre, për të qenë të gatshëm në përballimin e sfidave të pritshme. Ajo ndihmonte në bartjen e materialeve të luftës dhe në shtypjen e dokumentacionit që do t'i shërbenin komandës në veprimet e mëtejshme etj.⁵⁴

Krahas eprorëve të tjerë, merrte pjesë në përgatitjen e planeve të veprimeve luftarake të brigadës. Gjithashtu në fund të qershorit e gjatë muajit korrik, ajo kryesonte grupin e luftëtarëve për kontrollimin e terrenit brenda kufirit maqedonas, ku do të pozicionohej brigada për të filluar sulmin. Pas përgatitjeve intensive për sistemimin e ushtarëve dhe hapjen e pozicioneve për luftë, më 29 korrik 2001 gjatë kryerjes së një aksioni të rëndësishëm luftarak, te Zabeli i Kukulit të Gostivarit, bien në krye të detyrës Hyrë Emini (e cila sapo kishte mbushur 28 vjeç), komandant Tahir Sinani, Brahim Ademi nga Kosharja e Ferizajt, Naser Ademi e Isa Fazliu nga Gostivari. Plagosen rënd, Vjollca Neziri nga Prelezi i Ferizajt dhe Hajrush Fejzulli nga Rakoveci i Tetovës.⁵⁵ Rënia e Hyrës dhe katër dëshmorëve të tjerë,

⁵² Intervistë e Ali Ahmetit për: "UÇK, dokumentar i Tetes dhe Mirës", pjesa 4.

⁵³ Vjollca Neziri, kujtime për Hyrë Eminin.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Vjollca Neziri, kujtime për Hyrë Eminin.

ndonëse ndërpreu përpjekjet për realizimin e idealit të tyre për çlirimin e bashkimit të trojeve etnike, i kontribuoi drejtpërdrejt arritjeve të rëndësishme në përmirësimin e statusit politik e shoqëror të shqiptarëve në Kosovën Lindore dhe të Maqedonisë. Për gjithçka që bëri dhe sakrifikoi në shërbim të çështjes kombëtare, Hyrë Emini është vlerësuar me Urdhrin “Hero i Kosovës”, me Urdhrin “Luftëtar i Lirisë “Adem Jashari”, për trimëri në luftën për liri është shpallur dëshmore e kombit, si dhe më shumë mirënjohje e medalje të tjera.⁵⁶

⁵⁶ Marrë nga arkivi i familjes.